



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 105 Prot

Tiranë, më 29/07 2010

VENDIM Nr. 12 dt. 27.07.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 27.07.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

I. Lidhur me: Diskutimi i projekteve të financuara nga donacione

1. **Miratohet:** Projektin e restaurimit të Qendrës historike të Shkodrës, të financuar nga Komisioni Evropian, punuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, me reflektimin e vërejtjeve të bëra nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, me kondicionin: Nëse do të lejohet qarkullimi i makinave, lartësia e trotuarit reduktohet nga 15 në 8 cm
2. **Miratohet:** Projekt restaurimi i fasadave të sheshit "Nënë Tereza", Tiranë.
3. Projekt rikonstruksioni dhe shtesë kati për ndërtimin e Universitetit "UFO" në Berat.  
Nisur edhe nga thëniet e projektuesit, projekti miratohet me kondicionet:
  - a) Materiali i përdorur në fasadë do të jetë monumental, kryesisht travertinë.
  - b) Projekti do të marrë parasysh variantin me prerje në lartësi, përkatësisht me linja të drejta dhe jo harkore.
4. **Miratohet:** Projektin e ndërhyrjet konservuese – restauruese në bazilikën e Shën Janit, Delvinë.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR  
AKADEMIK. APOLLON BAÇE